



Ville de Lausanne

Bureau lausannois pour
les immigrés (BLI)

SQ

MIRË SE VINI



Të jetosh në Lozanë Një udhërrëfyes praktik



Botuesi: Qyteti i Lozanës, Bureau lausannois
pour les immigrés (BLI), në bashkëpunim me zyrën «Info Cité»

Dizenjo: alafolie.ch

Ilustrimet: Alexandre Pointet

Fotoja e kapakut: © Schweiz Tourismus / Giglio Pasqua

Shtypja: PCL Presses Centrales SA

Qershor 2023, botimi i 8-të

Me mbështetjen e:



Lënda

Mirë se vini në Lozanë	4
Qyteti i Lozanës shkurtimisht	6
Për t'u vendosur në Lozanë: çfarë duhet të bëni të parën?	8
Oferta mirëseardhjeje në Lozanë	9
Specialistët për migrimin, integrimin dhe luftën kundër racizmit	11
Informacione dhe kontakte (sipas temave)	
– Lejet e qëndrimit	14
– Banesa	16
– Puna	20
– Kurse të frëngjishtes dhe formime	23
– Shkolla	25
– Familja	28
– Sigurimet	31
– Shëndeti	34
– Transportet	38
– Financat, tatimet dhe telekomunikacionet	42
– Argëtimet	45
– Jeta qytetare	47
Plani i Lozanës	50

Legjendat e piktogrameve

 Informacione në shumë gjuhë

 Gjejini në plan (f. 50)

Mirë se vini në Lozanë

Lozana, një qytet gjithëpërfshirës


Të administrosh një qytet si Lozana do të thotë të kërkohsh gjithmonë një baraspeshë midis qëndrueshmërisë dhe zhvillimit dhe të pajtossh interesa nganjëherë divergjente. E sidomos të kontribuosh në marrëveshjen sa më të harmonishme të mundur midis banoreve dhe banorëve, si dhe gjithë bashkësive që e përbëjnë atë. Këto çështje janë posaçërisht të rëndësishme në Lozanë. Sepse qyteti ynë ka 150'000 banore dhe banorë, prej të cilave/cilëve 42 % nuk e kanë pasaportën zvicerane.

Shumëllojshmëria e origjinave, përfshirë atë shoqërore, është një shans: ajo i pasuron kulturat përkatëse, përmes shkëmbimeve midis tyre. Ajo e zgjeron horizontin tonë. Ajo na mëson ta njohim e ta respektojmë njëri-tjetrin. Por ajo mund të përbëjë edhe një brishtësi, nëse ne nuk arrijmë ta integrojmë secilën e secilin, duke respektuar kulturat e të gjithave e të të gjithëve.

Nëse Lozana ia ka dalë mbanë dhe është një shembull hapjeje dhe shumëllojshmërie, kjo ndodh posaçërisht në sajë të përpjekjeve të bëra nga Zyra lozaneze për të imigruarit (Bureau lausannois pour les immigrés - BLI) dhe partnerët e saj. Në sajë të punës së tyre të përditshme, ata kontribuojnë për ta bërë Lozanën një qytet gjithëpërfshirës, pritës dhe të këndshëm për të jetuar për të gjitha e të gjithë. Kjo broshurë është një shembull i kësaj.

5.2.1

Grégoire Junod, Kryetar i bashkisë i Qytetit të Lozanës



Një broshurë për të jetuar në Lozanë dhe për tu ndjerë mirë atje

Lozana, me 160 kombësitë e veta që jetojnë së bashku, është pa asnjë dyshim një qytet kozmopolit. Të takosh, të shkëmbesh e të diskutosh do të thotë të krijosh lidhje dhe të njihesh më mirë. Kjo na krijon bazën e domosdoshme për tu ndjerë mirë atje ku banojmë, punojmë, studiojmë dhe zhvillojmë veprimtari sportive, kulturore e argëtuese. Kjo është të jesh pjesë e qytetit tonë. Kjo është të jetosh në Lozanë.

Qyteti i Lozanës, me partnerët e vet, angazhohet çdo ditë për të na garantuar një vend secilës e secilit prej nesh dhe për të siguruar barazinë midis të gjithave e të gjithëve, cilado qoftë origjina, mosha apo gjinia jonë. Broshura «Të jetosh në Lozanë: një udhërrëfyes praktik» është reflektim i këtij angazhimi. Ajo merr pjesë në bërjen e Lozanës një qytet të hapur për tërë banoret e banorët e saj.


Ju do të gjeni atje informacione të shumta praktike, në një gjuhë të thjeshtë, për të gjitha aspektet e jetës së përditshme: strehim, punë, shkollë, financa apo edhe argëtime e formim. Ajo synon të jetë e dobishme për gjithë të ardhurit rishtazi në Lozanë, për ata që jetojnë atje prej disa muajve apo prej një kohe të gjatë, si edhe për ata që interesohen për qytetin tonë dhe kuadrin jetësor të tij.

Kjo broshurë është rezultat i një bashkëpunimi të frytshëm midis Zyrës lozaneze për të imigruarit (Bureau lausannois pour les immigrés - BLI), shërbimeve të ndryshme të administratës bashkiake, shoqatave të shumta dhe organizmave publike që veprojnë në rrethin e Lozanës. Dëshiroj t'u shpreh atyre gjithë mirënjohjen time për kontributin e tyre.

Ju uroj një zbulim të këndshëm të të gjithë pasurisë së qytetit tonë!



Émilie Moeschler, anëtare e organit ekzekutiv të Bashkisë,
Drejtorja e sporteve dhe kohezionit social



Qyteti i Lozanës shkurttimisht

Lozana, qytet i katërt i Zvicrës, karakterizohet si qytet olim-pik e i qëndrueshëm, por edhe si një vend formimi e kulture. Lozana, që është një destinacion turistik shumë i vlerësuar, pret edhe ndërmarrje të shumta ndërkombëtare. Ajo ofron njëherazi jetesë cilësore dhe atraktivitet ekonomike.



3 KODRA


mbi të cilat është ndërtuar qyteti i Lozanës

18

LAGJE
LOZANEZE



5



LAJMËRIMET E ORËS

nga tellallja ose tellalli i
Katedrales çdo natë

33 HEKTARË

vreshta, që i përkasin Qytetit

100 ANËTARË

në Këshillin bashkiak



500

METRA

disnivel midis
pjesës së sipërme
e asaj të poshtme
të qytetit

42 %

E POPULLSISË LOZANEZE

nuk e ka pasaportën zvicerane

168

KOMBËSI



23'000

NDËRMARRJE në Lozanë e në rrethin e saj

1803

viti në të cilin Lozana u
bë kryeqytet i kantonit
të Vaudit



350 HEKTARË

parqe e kopshte



150'000

BANORË.E TË REGJISTRUAR.A në janar të vitit 2023



39'000 STUDENTË.E

që formohen
çdo vit në
Lozanë

215'000

VENDE PUNE TË KRIJUARA nga ekonomia lokale

Të vendosesh në Lozanë: çfarë duhet të bësh të parën?

Kur arrini në Lozanë, duhet të bëni disa përçapje. Shpesh, afatet për t'i bërë ato janë të shkurtra. Ja lista e përçapjeve, e klasifikuar sipas rendit të përparësisë.

- Regjistrimi në Shërbimin e kontrollit të banorëve (Service du contrôle des habitants) (afati 14 ditë) (f. 16)
- Kërkesa për leje qëndrimi (sa më shpejt) (f. 14)
- Kontrata e sigurimit shëndetësor të detyrueshëm (afati 3 muaj) (f. 31)
- Regjistrimi i fëmijëve në shkollë (f. 25)
- Regjistrimi në Shërbimet industriale të Lozanës (Services industriels de Lausanne) (f. 16)
- Kontrata e sigurimi kundër zjarrit (f. 33)
- Lajmërimi pranë Administratës kantonale të tatimeve (Administration cantonale des impôts) (f. 42)
- Ndërrimi i lejes së huaj të drejtimit të automjeteve dhe kërkesa për targa zvicerane për veturën tuaj (afati 12 muaj) (f. 40)

Keni pyetje?

Në këtë broshurë, do të gjeni informacione të shumta. Do të gjeni edhe mënyrat për të kontaktuar njerëzit dhe shërbimet që mund t'ju vijnë në ndihmë.



Oferta mirëseardhjeje në Lozanë

Rreth 15'000 veta vendosen çdo vit në Lozanë; popullsia e saj numëron 160 kombësi. Ngado që ju të vini, Qyteti i Lozanës dëshiron t'jua lehtësojë ardhjen.

Pritje në Bashki

Çdo vit, Qyteti i Lozanës i fton të ardhurit rishtazi në një mbrëmje. Atje janë të pranishëm anëtarë të organit ekzekutiv të Bashkisë («Municipalité») dhe të shërbimeve të administratës për t'ju uruar mirëseardhjen dhe për t'ju informuar mbi veprimtaritë e tyre. Janë të pranishëm edhe përkthyes.


 www.lausanne.ch/accueil

Info cité

Info cité është një vend informimi kryesor, në Qytetin e Lozanës.

Ai i këshillon lozanezet dhe lozanezët lidhur me përçapjet administrative dhe i shoqëron në plotësimin e dëshirave të tyre për të zbuluar gjëra të reja. Ai jep gjithashtu informacione dhe dokumentacion në përgjigje të pyetjeve të shumta dhe drejton te shërbimet kompetente.

Info cité

 Place de la Palud 2, 1002 Lausanne
Tel. 021 315 25 55, infocite@lausanne.ch
www.lausanne.ch/infocite
Nga e hëna deri të premten ora 8.00-17.00



Broshura «Të jetosh në Lozanë: një udhërrëfyes praktik»

Broshura që keni në dorë është botuar nga Zyra lozaneze për të imigruarit (Bureau lausannois pour les immigrés - BLI). Ajo ekziston në 12 gjuhë. Këtë broshurë mund ta gjeni në sportelet e BLI-së, Info cité -së dhe ato të Kontrollit të banorëve të Qytetit të Lozanës.

- 📍 **Bureau lausannois pour les immigrés (BLI)**
- 🌐 Place de la Riponne 10, 1002 Lausanne
- Tel. 021 315 72 45, bli@lausanne.ch, www.lausanne.ch/bli
- Nga e hëna deri të premten ora 8.00-12.00, 13.00-17.00

«Te jetosh, të formohesh, të punosh»

Shërbimi i gatshëm falas «Të jetosh, të formohesh, të punosh» i Zyrës lozaneze për të imigruarit (Bureau lausannois pour les immigrés - BLI) ju informon, në gjuhën tuaj, lidhur me punësimin, formimin dhe jetën e përditshme në Lozanë. Ky shërbim përgjigjet në frëngjisht, spanjisht, portugalisht e anglisht. Për gjuhë të tjera, mund të kërkonti praninë e një interpreteje apo të një interpreti.

- 📍 www.lausanne.ch/permanence-bli
- 🌐 Të hënë ora 17.00-19.00, të shtunë ora 10.00-12.00

Në kuadrin e shërbimit të gatshëm «Të jetosh, të formohesh, të punosh», BLI-ja thërret rregullisht interpretë komunitarë të shoqatës «Appartenances» për të përkthyer bisedat. Edhe ju mund të kërkonti ndihmën e kësaj shoqate. Posaçërisht për përkthimin me shkrim të disa dokumenteve (diploma apo akte lindjeje për shembull).

www.appartenances.ch



Specialistët për migrimin, integrimin dhe luftën kundër racizmit

Në Zvicër, ekziston një Ligj mbi të huajt dhe integrimin (Loi sur les étrangers et l'intégration - LEI). Sipas këtij ligji, të imigruarit duhet të priten dhe të informohen për vendin e ri të jetës, qysh me mbërritjen e tyre. Një nen i Kodit penal (261bis du Code pénal) dënon gjithashtu sjelljet raciste. Shumë institucione, shoqata dhe individë kanë për mision zbatimin e këtyre ligjeve. Po ju paraqesim këtu disa nga këto organizata.

Zyra lozaneze për të imigruarit (Bureau lausannois pour les immigrés - BLI)

BLI-ja është zyra e Qytetit të Lozanës e specializuar në fushën e integritimit e të parandalimit të racizmit. Ajo favorizon bashkëjetesën dhe barazinë e shanceve. Ajo mbështet edhe organin ekzekutiv të Bashkisë («Municipalité») në politikën e tij të integritimit.


BLI-ja ndodhet në qendër të qytetit. Kjo zyrë i këshillon të gjithë, pavarësisht nga pasaporta, statusi apo vendi i origjinës. Ajo ju informon në shumë gjuhë, për tema si:

- Kurset e gjuhës frënge
- Gjetja e një pune apo një formimi
- Njohja e diplomave të mara jashtë vendit
- Jeta e përditshme në Lozanë
- Rastet e racizmit
- Të drejtat politike
- Realizimi i një projekti asociativ integrimi
- Marrja e shtetësisë (naturalisation)

BLI-ja është përgjegjëse edhe për shërbimin e gatshëm Info-racizëm (Info-racisme). Ky shërbim dëgjon dhe i jep informacione cilësdo e cilitdo që ballafaqohet me racizmin në Lozanë. Ky shërbim është falas dhe konfidencial.

Bureau lausannois pour les immigrés (BLI)
Place de la Riponne 10, 1002 Lausanne
Tel. 021 315 72 45, bli@lausanne.ch
www.lausanne.ch/bli
Nga e hëna deri të premten ora 8.00-12.00, 13.00-17.00

Permanence Info-racisme
Place de la Riponne 10, 1002 Lausanne
Tel. 021 315 20 21, info-racisme@lausanne.ch
www.lausanne.ch/info-racisme
Të hënën, të mërkurën, të enjten ora 14.00-17.00 ose me takim



Zyra kantonale për integrimin e të huajve dhe parandalimin e racizmit (Bureau cantonal pour l'intégration des étrangers et la prévention du racisme - BCI)

BCI-ja është një shërbim i Kantonit të Vaud-it i specializuar në fushën e integritit dhe të parandalimit të racizmit. Ajo ka zyra në Lozanë dhe në tri qytete të tjera Në kantonin Vaud. Broshura e BCI-së «Mirë se vini në kantonin e Vaud» u jep informacione të imigruarve të mbërritur rishtazi në territorin vaudez. Këto informacione, që janë të përkthyer në 16 gjuhë, gjenden në sitin e internetit:

www.vaud-bienvenue.ch

BCI-ja ofron gjithashtu konsultime falas për këdo që është viktimë apo dëshmitar aktesh me karakter racist a diskriminues në kantonin e Vaudit, jashtë Lozanës. Ato bëhen vetëm me takim dhe, sipas kërkesës, në shumë gjuhë.

Bureau cantonal pour l'intégration des étrangers et la prévention du racisme (BCI)
Avenue de Sévelin 46, 1014 Lausanne
Tel. 021 316 49 59, info.integration@vd.ch
www.vd.ch/integration

La Fraternité - Centre social protestant Vaud (CSP Vaud)

La Fraternité - CSP Vaud është atje për të gjithë, zviceranë e të huaj, që kërkojnë informacione në lidhje me migrimin. Kjo shoqatë mund t'ju ndihmojë gjithashtu në përçapjet tuaja administrative, juridike dhe sociale. Për shembull: një kërkesë për leje qëndrimi a për bashkim familjar.

📍 Centre social protestant Vaud (CSP Vaud) - La Fraternité

Place Arlaud 2, 1003 Lausanne

Tel. 021 560 60 98, frat@csp-vd.ch, www.csp.ch/fraternite

Shërbimi i gatshëm «Info-conseil», pa takim, të martën e të enjten nga ora 17.00 deri në 19.00, ndërsa për njerëzit pa dokumente nga ora 9.00 deri në 12.00

Shoqatat e të imigruarve

Në kantonin e Vaudit dhe në Lozanë, ka shoqata të shumta të ngritura nga dhe për të imigruarit. Në kuadrin e këtyre shoqatave, ju mund të takoni njerëz që vijnë nga vendi juaj apo që flasin gjuhën tuaj. Listen e tyre do ta gjeni në sitin e internetit të Zyrës lozaneze për të imigruarit (Bureau lausannois pour les immigrés - BLI).

www.lausanne.ch/associations-migrants

Rainbow Spot

Shoqata Rainbow Spot mbështet personat LGBTQI+ të dalë nga gjiri i të imigruarve të cilët banojnë në kantonin e Vaudit. Ajo i informon ata dhe i shoqëron në përçapjet e tyre administrative, juridike e sociale. Kjo shoqatë u mundëson gjithashtu personave LGBTQI+ që të takohen.

🌐 www.rainbowspot.ch



Informacione dhe kontakte

Lejet e qëndrimit

Politikat migruese zvicerane

Përçapjet për leje qëndrimi ndryshojnë sipas vendeve nga vini. Zvicra bën dallim midis njerëzve që vijnë:

- nga Bashkimi evropian dhe Shoqata evropiane e shkëmbimit të lirë (Union européenne et de l'Association européenne de libre-échange - UE/AELE).
Lista e vendeve anëtare të UE/AELE-së gjendet në fund të kësaj faqeje¹
- nga shtete të treta (d.m.th. të gjitha vendet jashtë UE/AELE-së)

Lejet e qëndrimit

Çdo person me shtetësi të huaj që dëshiron të vendoset në Zvicër për më shumë se 3 muaj ka nevojë për leje qëndrimi. Pikërisht për të:

- punuar e studiuar në Zvicër
- shkuar te një anëtar i familjes së tij

Ekzistojnë lejet e qëndrimit si më poshtë:

- L leje qëndrimi afatshkurtër
- B leje qëndrimi
- C leje vendosjeje
- G leje qëndrimi për kufitarë.e (frontalier.ère)

Ku mund të kërkonti një leje qëndrimi? Nëse vini nga «UE/AELE»-ja, shkoni në kontrollin e banorëve të bashkisë. Nëse vini nga një shtet tjetër (i quajtur vend i tretë), shkoni në ambasadën apo konsullatën zvicerane në vendin tuaj të rezidencës. Këto institucione bëjnë pastaj lidhjen me autoritetin kompetent, në këtë rast me Shërbimin e popullsisë të kantonit të Vaudit (Service de la Population du canton de Vaud).

1. Gjermani, Austri, Belgjikë, Bullgari, Qipro, Kroaci, Danimarkë, Spanjë, Estoni, Finlandë, Francë, Greqi, Hungari, Irlandë, Islandë, Itali, Letoni, Lihtenshtajn, Lituani, Luksemburg, Maltë, Norvegji, Holanda, Poloni, Portugali, Republika çeke, Rumani, Sllovaki, Slloveni, Suedi (lista e përditësuar më 01.01.2023)



Strehimi (Asile)

Ata që kërkojnë strehim në Zvicër mund të marrin leje qëndrimi. Vendimet për këtë merren nga Konfederata. Ekzistojnë lejet e qëndrimit si më poshtë:


- N leje qëndrimi për strehimkërkues.e
- B leje qëndrimi pas marrjes së strehimit
- F për pranim të përkohshëm
- S për mbrojtje të përkohshme

Lidhur me lejet e qëndrimit, ju do të gjeni informacione të hollësishme në gjuhën tuaj në broshurën «Mirë se vini në kantonin e Vaud» dhe në sitin e internetit:

 www.vaud-bienvenue.ch

A e dinit se?

Ata që nuk kanë dokumente mund ta rregullojnë gjendjen e tyre me disa kushte. A ju intereson kjo? Kërkoni këshilla nga shërbimi i gatshëm për njerëzit pa dokumente i shoqatës «Fraternité - CSP Vaud" (shih f. 13).



Banesat

Regjistrimi në Shërbimin e kontrollit të banorëve (Service du contrôle des habitants)

Të gjitha banoret dhe të gjithë banorët e Lozanës duhet të regjistrohen në kontrollin e banorëve. E këtë duhet ta bëjnë, brenda 14 ditëve pas mbërritjes së tyre.

Fillimisht, duhet të dërgoni informacionet dhe dokumentet e mëposhtme:

- Gjeneralitetet e plota (mbiemri, emri, datëlindja, shtetësia)
- Datën e mbërritjes në Lozanë
- Adresën në Lozanë
- Kopjen e letrës së njoftimit
- Nëse vini nga një vend i huaj, duhet të tregoni edhe arsyen e qëndrimit.

Ju mund t'i dërgoni këto informacione me shkrim ose me postë elektronike.

Pastaj, Shërbimi i kontrollit të banorëve do t'ju kontaktojë. Sipas gjendjes suaj vetjake, ai do t'ju kërkojë saktësime. Në fakt, gjendja e secilit është e ndryshme.

Ju mund të konsultoni edhe sitin e internetit.

Service du contrôle des habitants (CH)

Rue du Port-Franc 18, 1002 Lausanne. Tel. 021 315 31 33, ch@lausanne.ch
www.lausanne.ch/ch. Nga e hëna deri të premtën ora 8.00-11.30, 13.00-16.30

Shërbimet industriale të Lozanës (Services industriels de Lausanne - SiL)

Shërbimet industriale të Lozanës merren me rrymën elektrike dhe gazin, në Lozanë. Pasi të regjistroheni pranë kontrollit të banorëve, ju duhet të regjistrohni edhe në SiL (vetëm nëse banesa apo kontrata e qiramarrjes është në emrin tuaj). Këtë përçapje mund ta bëni:

- Me internet
- Në sportel
- Me telefon

Services industriels de Lausanne (SiL) - Espaces clients

Place Chauderon 23, 1002 Lausanne
Nga e hëna deri të premtën ora 8.00-12.00, 13.00-17.00
Place de l'Europe 2, 1002 Lausanne
Nga e hëna deri të premtën, ora 9.00-18.30, të shtunën ora 9.00-17.00
Tel. 0842 841 841, www.lausanne.ch/sil





Kërkim banese

Në Lozanë, për të kërkuar një apartament apo shtëpi, përdorni internetin. Ju do të gjeni lajmërimi në:

- www.homegate.ch
- www.immoscout24.ch
- www.immostreet.ch
- www.anibis.ch

Mos harroni po ashtu të flisni me të afërmit dhe të përdorni rrjetet sociale!

Kontrata e qiramarrjes

Nëse vizitoni një banesë që ju intereson, ju mund të depozitoni dosjen tuaj pranë agjencisë administruese ose pronarit. Në këtë dosje, në përgjithësi vihen kopje të dokumenteve të mëposhtme si:


- Letra e njoftimit (dhe leja e qëndrimit)
- Fishat e rrogës të tre muajve të fundit
- Sigurimi «RC-Ménage» (shih f. 33)
- Ekstrakt i Zyrës së ndjekjes për borxhe (Office des poursuites)

Nëse ju jepet banesa, do të nënshkruani një kontratë qiramarrjeje (bail à loyer) dhe do të paguani një garanci qiraje para se të hyni në të.

Në Zvicër, qiranë e banesës e paguani çdo muaj. Ajo quhet «loyer». Shuma e qirasë përfshin edhe detyrimet (ujë, ngrohje, administrim, etj.) por jo rrymën elektrike (shih SiL f. 16).

Garancia e qirasë

Garancia e qirasë shpesh përkon me shumën e qirasë të 3 muajve. Kjo shumë depozitohet në një llogari bankare. Kur ju dilni nga banesa, nëse gjithçka është në rregull, kjo shumë ju kthehet. Nuk keni mjaftueshëm para? Kërkoni hua nga një shoqëri garancie (société de cautionnement)! Kujdes: për shumën e huazuar do të paguani interesa.



Gérance Ville

Shërbimi i agjencive administruese (Service des gérances) i Qytetit të Lozanës është përgjegjës për shumë banesa, lokale tregtare dhe objekte të tjera që jepen me qira. Ofertat e tyre dhe veprimet për marrje me qira, do t'i gjeni në adresën www.lausanne.ch/immobilier, në emrin «Gérance Ville». Me qëllim që në zgjedhjen e qiramarrësve të garantohet paanësia, kjo gjë i është deleguar një komisioni.

📍 Service des gérances

Place Chauderon 9, 1002 Lausanne. Tel. 021 315 49 49, gerances@lausanne.ch
www.lausanne.ch/service-ger
Nga e hëna deri të prenten ora 8.00-11.30, 13.00-16.30

Atelie «Infolog»

Keni nevojë për ndihmë për gjetjen e një banese? Ndhimëse sociale e ndihmës social të Dispozitivit të ndihmës sociale për banesat (Dispositif d'aide sociale au logement) të Qytetit të Lozanës mund t'ju këshillojnë e t'ju shoqërojnë. Shërbimi «Infolog» propozon seanca informimi dhe atelje për kërkim banese, falas e pa regjistrim paraprak.

Dispositif d'aide sociale au logement

Rue de l'Ale 31, 1002 Lausanne
Tel. 021 315 76 27, të martën, nga ora 13.30 deri në orën 15.30

Festa e fqinjëve-ëve (Fête des Voisin·e·s)

Çdo vit, të premten e fundit të muajit maj, bëhet Festa e Fqinjëve «Fête des Voisin·e·s». Kjo ngjarje ju mundëson njohjen më të mirë të fqinjëve e fqinjëve tuaj. Kjo është e dobishme nëse jeni të porsa ardhur në Lozanë. Shërbimi i arkitekturës dhe banesave (Service d'architecture et du logement) i Qytetit të Lozanës ju ndihmon me dëshirë për organizimin e kësaj feste.

📍 Service d'architecture et du logement

Place Chauderon 9, 1002 Lausanne. Tel. 021 316 56 22
lafetedesvoisins@lausanne.ch, www.lausanne.ch/lafetedesvoisins

«I ♥ mes voisins. Le guide du bon voisinage»

Ky udhërrëfyes sjell në kujtesë disa rregulla të thjeshta për favorizimin e një bashkëjetese të mirë. Kjo broshurë është në shumë gjuhë. Ajo është botuar nga Zyra lozaneze për të imigruarit (Bureau lausannois pour les immigrés - BLI) në bashkëpunim me Shërbimin e arkitekturës dhe të banesave (Service d'architecture et du logement)



🌐 www.lausanne.ch/bli > publications

Shoqata e mbrojtjes së qiramarrësve (Association de défense des locataires - ASLOCA)

ASLOCA është një shoqatë e specializuar në fushën e së drejtës të qiramarrësve. Ajo i informon ata mbi të drejtat e tyre dhe i mbron kur ato nuk respektohen. Ajo i ndihmon qiramarrësit për të gjetur zgjidhje për problemet e tyre, në sajë të shërbimeve të gatshme dhe të bisedave individuale. Dëshironi të bëheni anëtar i saj dhe të përfitonit nga këto shërbime? Regjistrohuni në internet:

vaud.asloca.ch

Përzgjedhja e mbetjeve

Qyteti i Lozanës ka ngritur një sistem përzgjedhjeje të mbetjeve i cili siguron mbrojtjen e mjedisit dhe përfitim e energjisë. Ekzitojnë mbajtëse mbetjesh të llojeve të ndryshme dhe vende të ndryshme përzgjedhjeje. Mbetjet shtëpiake - ato që nuk mund të përzgjidhen, si për shembull mbetjet plastike - duhet të hidhen në thasë plastike zyrtarë të blertë e të bardhë (pastaj në mbajtësen e mbetjeve të ndërtesës suaj). Ju mund t'i blini këta thasë të përmasave të ndryshme në treg (supermarché).


Mbetjet e riciklueshme, si për shembull letra, qelqi dhe mbetjet biologjike (që quhen edhe «compost»), duhet të hidhen në mbajtëse pranë banesës suaj. Aluminin, hekurin e bardhë, vajrat minerale e vegjetale, si dhe tekstilet mund t'i hidhni tek ekopikat (écopoints) e lagjes suaj. Druri, «le PET» dhe pajisjet elektronike çohen në pika grumbullimi në vende të palëvizshme ose të lëvizshme (vendndodhjet dhe datat e grumbullimit së tyre janë në sitin www.lausanne.ch/ramassage).

Si t'i përzgjidhni mirë mbetjet tuaja? Një fletushkë në shumë gjuhë shpjegon se si përzgjidhen mbetjet në Lozanë. Ju do ta gjeni atë në sitin e internetit të Qytetit:

 www.lausanne.ch/trier

A e dinit se?

Në kantonin e Vaudit, 7 familje në 10 e marrin me qira banesën. Në krahasim me vende të tjera, ndodh më rrallë që të jesh pronar sesa qiramarrës.





Puna

Kërkimi i punës

A kërkoni punë? Në Zvicër, për të kërkuar dhe gjetur punë, ndër të tjera ju mund:

- T'u përgjigjeni ofertave të punës në internet (për shembull në sitin www.jobup.ch)
- Të regjistroheni në një agjenci punësimi (si Adecco, Planet Interim, Career Plus, etj.)
- Të kontaktoni ndërmarrjet që ju interesojnë duke u dërguar kërkesa spontane
- Të flisni në rrethin tuaj shoqëror ose në rrjetet sociale

Shërbimi i gatshëm i BLI-së «Të jetosh, të formohesh, të punosh» ju informon dhe ju këshillon në gjuhën tuaj, lidhur me përçapjet që duhet të bëni për kërkimin e punës (shih f. 10).

Dosja e kandidaturës

Për t'u përgjigjur një propozimi për punë, në përgjithësi dërgohet një dosje kandidature. Në atë dosje futen kopjet e dokumenteve të mëposhtme:

- Letër motivimi
- Curriculum vitae CV
- Çertifikatat e punës
- Vërtetimet e formimit


Pasi mbërrini në Zvicër, sigurohuni që këto dokumente të jenë aktuale, në gjendje të mirë e të përkthyer në frëngjisht. Kjo bën që ju t'u përgjigjeni shpejt ofertave për punë dhe t'i vini të gjitha shanset në anën tuaj.

Keni nevojë për ndihmë në përgatitjen e dosjes së kandidaturës? Në Lozanë, ka njerëz që mund t'ju ndihmojnë për (ri)bërjen e Cv-së suaj dhe për shkrimin e letrës suaj të motivimit. Ata quhen shkruer publikë (écrivains publics).

Për shembull:

Les scribes www.lesscribes.ch ose

Point d'Appui www.eglisemigrationvd.com



Kontrata e punës

Në Zvicër, një kontratë pune është e përcaktuar (e kufizuar në kohë) ose e papërcaktuar (e pakufizuar në kohë). Ajo mund të jetë gjithashtu për një veprimtari me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme. Ajo është e vlefshme qysh nga momenti që ju dhe punëdhënësi pajtoheni me kushtet e marrjes në punë. Pra, edhe një kontratë e bërë gojarisht është e vlefshme, por rekomandohet që ajo të bëhet me shkrim dhe të nënshkruhet.

Keni pyetje lidhur me kontratën, kushtet e punësimit (si rroga, sigurimet sociale...) apo kushtet e punës në ndërmarrje (kohëzgjatja ligjore e punës dhe pushimit, mbrojtja e shëndetit, etj.)? Inspektorati i punës Lozanë (Inspection du travail Lausanne) mund të ju informojë.

📍 Inspection du travail Lausanne

Place de la Riponne 10, 1002 Lausanne

Tel. 021 315 76 80, itl@lausanne.ch, www.lausanne.ch/itl

Nga e hëna deri të premten, ora 8.00 deri në orën 11.30 dhe

nga ora 13.00 deri në orën 17.00

Të mërkurën ora 13.00-17.00 vetëm me telefon (paradite mbyllur)

Rroga

Rroga është shuma e parave që punëdhënësja apo punëdhënësi ju derdh çdo muaj në shkëmbim të punës suaj. Në përgjithësi, ju mund ta negocioni rrogën tuaj gjatë takimit të marrjes në punë. Për ta ditur se çfarë rroge mund të kërkonit (në funksion të profesionit dhe të përvojës suaj), konsultoni sitin e internetit www.lohnrechner.ch.

Në Zvicër, ekzistojnë ato që quhen konventa kolektive të punës (conventions collectives de travail - CCT). Ato garantojnë kushte të mira pune dhe rrogë të përshtatshme. Këto marrëveshje bëhen midis sindikatave (shoqata që përfaqësojnë punonjëset e punonjësit) dhe punëdhënësëve e punëdhënësëve. Në Zvicër ka shumë sindikata. Më e madhja quhet UNIA.

www.unia.ch

Ata që jetojnë e punojnë në Zvicër duhet të paguajnë tatime. Tatimet llogariten sipas rrogës, pasurisë dhe gjendjes suaj familjare (shih f. 42).



Sigurimet sociale

Punonjëset e punonjësit në Zvicër përfitojnë nga sigurimet sociale, në të cilat ata duhet të regjistrohen prej punëdhënëseve e punëdhënësve. Shuma e kontributeve që u paguhen këtyre sigurimeve shënohet në fishën e rrogës që merrni çdo muaj.

- Kuotizacioni i AVS-së është i detyrueshëm, duke filluar nga 2'300 fr. të ardhura në vit (apo çfarëdo rroge në rastin e atyre që punojnë në banesa private).
- Regjistrimi në «2^e pilier» (që quhet edhe LPP) është i detyrueshëm, duke filluar nga 21'510 fr. të ardhura në vit.
- Sigurimi për aksidentet profesionale (LAA) është i detyrueshëm.

Nëse punoni mbi 8 orë në javë, punëdhënësja ose punëdhënësi duhet t'ju sigurojë për aksidentet profesionale e joprofesionale. Ju do të gjeni më shumë informacione për këto sigurime në faqet 31 deri në 33.

Papunësia

Cilido që kërkon punë, e humbet apo e lë atë mund të regjistrohet në Zyrën rajonale të punësimit (Office régional de placement - ORP). Për të marrë pagesa financiare nga papunësia («indemnités de chômage»), është e nevojshme që ju të jetoni zyrtarisht në Lozanë dhe të keni punuar në Zvicër të paktën 12 muaj gjatë 24 muajve të fundit. Po ashtu është e detyrueshme pasja e një lejeje qëndrimi. Këshilltaret dhe këshilltarët e ORP-së ju ndihmojnë për të (ri)gjetur punë sa më shpejt që të jetë e mundur. Për ata që kanë ardhur rishtazi e që kanë leje qëndrimi, ORP-ja propozon një shoqërim në kërkimin e punës, me kusht që të regjistroheni në sportelin e saj.

📍 Office régional de placement (ORP)

Place Chauderon 9, 1002 Lausanne

Tel. 021 315 78 99, orp@lausanne.ch, www.lausanne.ch/orp

Nga e marta deri të premten ora 7.30-11.45, 13.00-1700

A e dinit se?

Nëse punoni për një person apo një familje private (pastrim, mbajtje fëmijësh, kopshtari...), ju mund të merrni pjesë në programin «Chèques-emploi» të EPER-së. Kjo ju jep mbrojtje sociale.

www.chèques-emploi.ch

Kurse të frëngjishtes dhe formime

Kurse të frëngjishtes për të rritur

Të flasësh e të shkruash frëngjishten është me shumë rëndësi për gjetjen e një pune dhe integrimin shoqëror në Zvicrën romande. Dëshironi të mësoni frëngjishten? Ka institucione, shoqata e shkolla private që propozojnë kurse për të rritur, falas e me pagesë. Listën e kurseve do ta gjeni në broshurën «Të mësosh në Lozanë» (Apprendre à Lausanne) të Zyrës lozaneze për të imigruarit (Bureau lausannois pour les immigrés - BLI). Këto informacione gjenden në disa gjuhë.

 www.lausanne.ch/apal

Në verë, gjatë 5 javëve, BLI-ja propozon kurse të frëngjishtes, në nivelin fillestar, falas. Ato zhvillohen në breg të Liqenit «Léman», në «Vidy Plage», dhe mundësojnë mësimin e frëngjishtes në një ambient të qetë. Pritja dhe ruajtja e fëmijëve mbi 2 vjeç është e parashikuar, në mënyrë që prindërit të mund të ndjekin kurset.

www.lausanne.ch/vidy-plage

Njohja e diplomave të huaja

Ju keni diplomë të huaj dhe doni që ajo t'ju njihet edhe në Zvicër?

Kontaktoni Sekretariatit e shtetit për formimin, kërkimet dhe inovacionin (Secrétariat d'État à la formation, à la recherche et à l'innovation - SEFRI).

Ai do t'ju informojë nëse ajo ka barasvlefshmëri në Zvicër apo nëse duhet që ju të ndiqni formime plotësuese. Kujdes: kjo përçapje është me pagesë dhe mund të zgjasë disa muaj.

www.sbf.admin.ch

Shoqata «Découvrir» propozon shërbimin «Redes». Ky shërbim i ndihmon të imigruarit në kryerjen e veprimeve për njohjen e diplomave të tyre.

www.associationdecouvrir.ch



Orientimi profesional

Qendra e orientimit profesional e rajonit Qendër (Centre d'orientation professionnelle de la région Centre), në Lozanë, i informon dhe i këshillon të rriturit, adoleshentët.ët dhe nxënëset.it që ndjekin shkollën, lidhur me zgjedhjen e një profesioni. Ju mund të merrni takim falas me specialistët e saj për një bisedë individuale. Ju mund të kërkoni gjithashtu informacione pranë Qendrës së informimit mbi studimet dhe profesionet (Centre d'information sur les études et les professions - CIEP), e hapur çdo pasdite.

📍 Centre d'orientation professionnelle

Rue de la Borde 3d, 1014 Lausanne
Tel. 021 316 11 20, info.osp@vd.ch
www.vd.ch/orientation

Bursat dhe ndihmat në fushën e formimit

Me disa kushte, Zyra kantonale e bursave studimore dhe nxënësisë (Office cantonal des bourses d'étude et d'apprentissage - OCBE), Fondacioni lozanez i ndihmës për punën (Fondation lausannoise d'aide pour le travail - F.L.A.T) apo shoqata «Envol» mund t'ju ndihmojnë për të paguar një formim apo shpenzime të ndryshme profesionale. Konsultoni sitin e tyre të internetit, për të pasur më shumë informacione.

www.vd.ch/ocbe

www.lausanne.ch/flat

www.association-envol.info

A e dinit se?

Ju mund të gjeni formime të shumta, ku hyhet me lehtësi, për shembull në informatikë, byrotikë apo administrim buxheti, në sitin www.lausanne.ch/formations-migrants dhe në broshurën «Të mësosh në Lozanë» (Apprendre à Lausanne).

www.lausanne.ch/apal



Shkolla

Regjistrimi i fëmijëve në shkollë

Regjistrimi i fëmijëve në shkollë është një nga përçapjet përparësore që duhet të bëni menjëherë pas mbërritjes suaj. Për këtë, paraqituni në sportelin e Shërbimit shkollor e të jashtëshkollorit (Service des écoles et du parascolaire - SEP). Të gjitha përçapjet përqendrohen te ky shërbim, i cili pastaj i shpërndan fëmijët në institucionet shkollore të Lozanës. Përparësi ka shkolla që ndodhet më afër vendit të banimit.

Shërbimi shkollor e i jashtëshkollorit merret edhe me regjistrimin e fëmijëve në shërbimin e pritjes jashtëshkollore, para dhe pas shkollës (shih f. 29).

Në kantonin e Vaudit, në 10 fëmijë 9 janë në shkollën publike. Atje ata marrin mësim falas dhe me cilësi të lartë. Ju dëshironi megjithatë ta regjistroni fëmijën tuaj në një shkollë private? Konsultoni informacionet dhe listën e kontakteve të dobishme në sitin www.avdep.ch.

📍 Service des écoles et du parascolaire (SEP)

Place Chauderon 9, 1002 Lausanne

Tel. 021 315 64 11, sep@lausanne.ch, www.lausanne.ch/sep


Nga e hëna deri të premtën, ora 8.00 - 11.30, 13.00 - 16.30


Sistemi shkollor vaudez

Në kantonin e Vaudit, shkolla e detyrueshme vazhdon 11 vjet. Fëmijët e fillojnë shkollën në moshën 4 vjeç dhe e mbarojnë afër moshës 15 vjeç. Programi shkollor vaudez ndahet në disa shkallë, cikle e vite, nga 1P deri në 11S. Në sitin e DGEO-së, Drejtorisë së përgjithshme të arsimit të detyrueshëm dhe të pedagogjisë së specializuar të Kantonit të Vaudit (Direction générale de l'enseignement obligatoire et de la pédagogie spécialisée du Canton de Vaud), ju do të gjeni shpjegime mbi sistemin shkollor vaudez në 10 gjuhë. Atje do të gjeni edhe skema krahasuese të sistemit shkollor vaudez me ato të më shumë se 30 vendeve.

www.vd.ch/scolarité

🌐 Dokumente të përkthyer për informimin e prindërve





Nxënësit jo frëngjishtfolës nga 4 deri në 15 vjeç

Fëmijët nga 4 deri në 8 vjeç, të cilët, kur mbërrijnë në Lozanë, nuk flasin frëngjisht, shkojnë në shkollën filllore të lagjes së tyre. Pas një takimi pritës me prindërit, fëmija kyçet në një klasë të rregullt me kurse intensive të frëngjishtes.

Fëmijët e moshës 8 deri në 15 vjeç drejtohen për në Qendrën e burimeve për nxënësit jo frëngjishtfolës (Centre de ressources pour élèves allophones - CREAL). Pas një bisede me prindërit, fëmija kyçet në klasë pritjeje ose në klasë të rregullt me kurse intensive të frëngjishtes. Kur niveli i fëmijës në frëngjisht është i mjaftueshëm, ai shkollohet në një klasë të rregullt me kohë të plotë.

Në kantonin e Vaudit, nxënësit pa leje qëndrimi kanë të drejtën të shkojnë në shkollën e detyrueshme dhe atë të shkallës së dytë, si dhe në disa shkolla profesionale.

Nxënësit jo frëngjishtfolës nga 15 deri në 25 vjeç


Të rinjtë 15 deri në 25 vjeç jo frëngjishtfolës mund të futen gjatë një viti në një klasë të Shkollës së pritjes (École de l'accueil - EdA). Hyrja është e mundur sipas vendeve të lira. Në EdA, të rinjtë mësojnë frëngjishten, familjarizohen me vendin e ri të jetës dhe përgatisin vazhdimin e rrugëtimit të tyre.

Regjistrimi në EdA bëhet në Portalin Migration:

- Në sportelin e OCOSP-së (në katin e 4të)
- Me telefon
- Me internet

Portail Migration propozon edhe biseda pritëse për të rinjtë deri në 25 vjeç të dalë nga migrimi dhe në kërkim të një formimi.

Portail Migration (Unité Migration Accueil UMA)
Office cantonal d'orientation scolaire et professionnelle (OCOSP)
Rue de la Borde 3d, 1014 Lausanne
Tel. 021 316 11 40, www.vd.ch/orientation
Nga e hëna deri të enjten ora 8.00-12.00



Kurset e gjuhës e të kulturës së origjinës

Fëmijët që flasin mirë gjuhën e nënës mësojnë më lehtë një gjuhë të huaj. Prandaj shoqata, shkolla e ambasada propozojnë kurse të gjuhës e të kulturës së orgjinës. Në këto kurse, nxënësit thellojnë njohjen e gjuhës së nënës dhe të kulturës së origjinës. Kjo lehtëson mësimin e frëngjishtes dhe ndërtimin e identitetit të tyre të shumëfishtë.

Kurset e gjuhës dhe të kulturës së origjinës do t'i gjeni në broshurën «Të mësosh në Lozanë» (Apprendre à Lausanne) të Zyrës lozaneze për të imigruarit (Bureau lausannois pour les immigrés - BLI).

www.lausanne.ch/apal

A e dinit se?

Pasi të mbërrini në Lozanë, do të keni takime me mësueset dhe mësuesit e fëmijëve tuaj. Ju mund të kërkonit praninë e një interpreti për të përkthyer gjatë këtyre takimeve.



Familja

Bashkimi familjar

Nëse jetoni e punoni në Zvicër, ju mund të sillni edhe anëtarë të familjes suaj. Kjo quhet kërkesë për bashkim familjar. Kjo nuk bëhet në mënyrë automatike. Duhet të plotësoni disa kushte. Nëse vini nga Bashkimi evropian dhe Shoqata evropiane e tregtisë së lirë, bëjeni kërkesën pranë kontrollit të banorëve. Nëse vini nga një shtet i tretë, drejtohuni në ambasadën ose konsullatën zvicerane në vendin tuaj. Këto institucione ia përcjellin kërkesën tuaj Shërbimit të Popullsisë së kantonit të Vaudit (Service de la Population du canton de Vaud), i cili vendos.

Nëse vini nga një shtet i tretë keni një afat 5 vjeçar për të sjellë bashkëshortin. en tuaj ose fëmijët nën moshën 12 vjeç. Për fëmijët 12 deri në 18 vjeç, afati është vetëm 1 vit.

Gjendja civile

Keni pyetje lidhur me martesat, lindjet, ndryshimin e mbiemrit apo emrit, apo një vdekje? Ju do të gjeni informacione në sitin www.vaud-bienvenue.ch ose në sitin e internetit të Gjendjes civile të kantonit të Vaudit (État civil du canton de Vaud). Për shembull: hollësi mbi veprimet që duhet të bëni sipas kërkesës suaj.

État civil du Canton de Vaud

Avenue de Sévelin 46, 1004 Lausanne

Tel. 021 557 07 07, etat.civil@vd.ch, www.vd.ch/etat-civil

Martesat me detyrim

Quhet martesë me detyrim kur një person nuk mund të mos pranojë të martohet. Në Zvicër, cilado e cilido ka të drejtën të vendosë nëse do të martohet dhe me kë. Për viktimat apo dëshmitarët e një martese me detyrim, Zyra kantonale për integrimin e të huajve dhe parandalimin e racizmit (Bureau cantonal pour l'intégration des étrangers et la prévention du racisme - BCI) ofron konsultime falas.

 www.vd.ch/mariage-si-je-veux

Zgjidhje për çerdhe (nga 0 deri në 6 vjeç)

Në Lozanë, ju mund ta lini fëmijën tuaj nën kujdesin e një qendre jete fëmimore (Centre de vie infantine - CVE) - që quhen edhe çerdhe - ose pranë një pritëseje në mjedis familjar. Fjala është për një dado që mban fëmijë në banesën e vet. Këto shërbime janë me pagesë, por çmimi i tyre përshtatet me gjendjen tuaj familjare dhe me rrogën tuaj. Zyra lozaneze për familjet (Bureau lausannois pour les familles - BLF) ju informon për ofertat; ajo merret edhe me regjistrimet.

- 📍 **Bureau lausannois pour les familles (BLF)**
Place Chauderon 9, étage T, 1002 Lausanne
Tel. 021 315 60 00, www.lausanne.ch/blf
Nga e hëna deri të premten ora 8.30-11.30, 13.30-16.30

Keni nevojë për mbajtjen e fëmijës vetëm për disa orë gjatë javës? Në Lozanë, ka edhe kënde lojërash (haltes-jeux) e kopshte që gjithashtu presin fëmijë.

www.lausanne.ch/haltes-jeux

Pritja jashtëskollore (fëmijët nga 4 deri 12 vjeç)

Quhen pritje jashtëskollore ofertat e pritjes për fëmijët tuaj para e pas shkollës, si edhe gjatë pushimit të mesditës. Për të regjistruar fëmijët nga 4 deri në 6 vjeç (1P-2P), lajmërohuni në Zyrën lozaneze për familjet (Bureau lausannois pour les familles - BLF) (shih më sipër). Për fëmijët më të mëdhenj, shkoni në Shërbimin e shkollave dhe të jashtëskollorit (Service des écoles et du parascolaire - SEP) (shih më sipër). Është mirë ta dini: ky shërbim merret edhe me regjistrimin për detyrat me shoqërues.

- 📍 **Service des écoles et du parascolaire (SEP)**
Place Chauderon 9, 1002 Lausanne
Tel. 021 315 64 11, sep@lausanne.ch
www.lausanne.ch/sep
Nga e hëna deri të premten ora
8.30-11.30, 13.00-16.30



Veprimtaritë gjatë pushimeve

Gjatë pushimeve shkollore, Qendra e pritjes për pushime (Domaine accueil vacances) e Qytetit të Lozanës dhe partnerët e saj ofrojnë veprimtari të shumta për fëmijët. Inkuadrimi është profesional dhe çmimi i përballueshëm. Kontaktoni këtë shërbim për tu informuar dhe për të regjistruar fëmijët tuaj!

📍 **Domaine accueil vacances**

Place Chauderon 7a, étage T, 1002 Lausanne

Tel. 021 316 68 22, www.lausanne.ch/jeunessevacances


Nga e hëna deri të prmten ora 7.30-11.45, 13.00-16.30

A e dinit se?

Për të pasur një vend në çerdhe a kopsht, ju mund t'i regjistroni fëmijët tuaj qysh në muajin e 4të të shtatzënisë ose 1 vit para datës së hyrjes që dëshironi. Mos u vononi: kërkesat janë të shumta dhe do t'ju duhet ndoshta të prisni para se të keni një vend.



Sigurimet



Sigurimi shëndetësor i detyrueshëm (Assurance-maladie obligatoire - LAMal)

Në Zvicër, sigurimi shëndetësor është i detyrueshëm. Ky sigurim ju mundëson të hyni në sistemin shëndetësor dhe të përfitonit nga përkujdesje cilësore, duke paguar vetëm një pjesë të shpenzimeve. Pas mbërritjes, keni një afat 3 muaj për të nënshkruar një kontratë me një kompani sigurimi zvicerane. Ka shumë kompani sigurimi dhe ju mund ta zgjidhni lirshëm tuajën. Për të zgjedhur, shikoni se sa është pagesa mujore («la prime») (shuma që i paguhet çdo muaj sigurimit). Nëse keni nevojë për ndihmë, konsultoni në linjë sitet krahasues si www.priminfo.ch ose shkoni në Agjencinë e sigurimeve sociale lozaneze (Agence d'assurances sociales - AAS).

📍 **Agence d'assurances sociales (AAS)**
Place Chauderon 7, 1002 Lausanne
Tel. 021 315 71 00, www.lausanne.ch/sas
Nga e hëna deri të premten ora 8.30-11.45, 13.00-16.30
(mbyllur të enjten paradite)

Kujdes: ju duhet të paguani për sigurimin shëndetësor qysh nga dita e mbërritjes suaj në Zvicër. Nëse duhet të prisni disa javë (e shumta 3 muaj) për të bërë kontratën e sigurimit, ju duhet të paguani megjithatë edhe për javët e mëparshme. Fatura mund të jetë e lartë: parashikojeni këtë shpenzim në buxhetin tuaj!

Ndihma plotësuese për sigurimin shëndetësor të detyrueshëm (subside)

Pagesat mujore për sigurimin shëndetësor të detyrueshëm mund të përfaqësojnë një shpenzim të madh sipas rrogës suaj dhe numrit të personave që keni në ngarkim (familja, bashkëshorti/ja dhe fëmijët). Zyra vaudeze e sigurimit shëndetësor (Office vaudois de l'assurance-maladie - OVAM) jep ndihmë financiare për personat me gjendje ekonomike modeste në kantonin a Vaudit. Kjo ndihmë quhet «subside». Ju mund ta përllogarisni të drejtën tuaj për «subside» në sitin e internetit:

www.vd.ch/subside-assurance-maladie

Sigurimet plotësuese

Disa trajtime - si mjekësia natyrore - nuk merren përsipër nga sigurimi shëndetësor i detyrueshëm. Prandaj, ju mund të zgjidhni të merrni një apo disa sigurime plotësuese. Këto sigurime janë të vullnetshme: ju nuk keni detyrim të merrni ndonjë prej tyre dhe siguruksi është i lirë të pranojë apo të mos pranojë kërkesën tuaj. Prandaj, këshillohet që t'i siguronit fëmijët qysh herët dhe të mendoni mirë para se ta anuloni kontratën tuaj.

Sigurimet sociale

Në Zvicër, sigurimet sociale paguhen pjesërisht nga i punësuar dhe pjesërisht nga punëdhënësja ose punëdhënësi. Ato janë të rëndësishme sepse garantojnë një të ardhur në moshën e pensionit, në rast të një problemi shëndetësor, të një periudhe pa punë apo të vështirësive financiare. Nëse punoni, kuotizacionet e sigurimeve sociale ju mbahen nga rroga. Këtë mund ta shikoni në fishën e rrogës.

Ja lista e këtyre sigurimeve

- **AVS (1^{er} pilier) Sigurimi për pjeqërinë dhe të mbijetuarit:** për pensionin tuaj
- **AI Sigurimi për invaliditetin:** në rast problemi shëndetësor për një kohë të gjatë
- **PC Ndihmat plotësuese:** në rast detyrimesh tepër të larta
- **AC Sigurimi për papunësinë:** nëse e humbni apo e lini punën
- **LPP (2^e pilier) Parashikimi profesional:** për të kompletuar AVS/AI-në
- **APG Alokacione për humbjen e të ardhurave:** në rast të shërbimit ushtarak ose të lejes së lindjes (mëmësi/atësi)
- **Alokacione familjare:** ndihmë financiare për çdo fëmijë (me kërkesë)

Sigurimi për aksidentet (Assurance-accidents - LAA)

Ashtu si sigurimi shëndetësor, edhe sigurimi për aksidentet është i detyrueshëm në Zvicër. Nëse punoni të paktën 8 orë në javë te një punëdhënëse apo punëdhënës, sigurimi për aksidentet mbulon aksidentet profesionale dhe jo profesionale. Nëse punoni më pak se 8 orë në javë, sigurimi për aksidentet mbulon vetëm aksidentet profesionale. Nëse jeni e.i pavarur, ju duhet të siguroheni vetë.

Sigurimi për zjarrin dhe elementet natyrore (Assurance incendie et éléments naturels - ECA)

Në kantonin e Vaudit, sigurimi për zjarrin dhe elementet natyrore për banesën dhe për pasuritë tuaja të paluajtshme është i detyrueshëm. Në Lozanë, ju duhet të bëni një kontratë për këtë sigurim pranë Entit të sigurimit kundër zjarrit dhe elementeve natyrore të kantonit të Vaudit (Établissement d'assurance contre l'incendie et les éléments naturels du canton de Vaud - ECA). Ju mund ta bëni këtë në disa mënyra:

- Me internet
- Në sportel

📍 **ECA - Agence de Lausanne**
Avenue du Grey 111, 1002 Lausanne
Tel. 0800 721 721, www.eca-vaud.ch



Sigurime të tjera

Ekzistojnë edhe sigurime të tjera për pasuri dhe nevoja të veçanta.

Për shembull:

- **Përgjegjësi civile (RC) dhe banesën:** në rast dëmtimesh të të mirave tuaja materiale, të mobilieve tuaja apo të atyre të dikujt tjetër
- **Sigurim i jetës («3° pilier»):** në plotësim të AVS-së dhe të «2° pilier»-së (kuotizacionet zbriten nga tatimet)
- **Sigurim i automjeteve:** në rast prishjeje, aksidenti apo dëmtimesh të ndryshme të mjetit tuaj (makinë, motoçiletë, etj.)
- **Sigurim për udhëtimet:** në rast se duhet të anuloni një udhëtim, humbisni bagazhin apo keni një problem shëndetësor jashtë vendit
- **Ndihmë juridike:** për të marrë një avokat.e në rast problemi me ligjin
- **Sigurim i kafshëve:** nëse duhet të kuroni kafshën tuaj të shoqërisë

Këto sigurime bëhen me dëshirë, por janë të këshillueshme. Ato ju mbrojnë nga të papriturat e pakëndshme.

A e dinit se?

Ju mund ta ndërroni kontratën e sigurimit të detyrueshëm për sëmundjet çdo vit, para 30 nëntorit, për vitin vijues. Kërkesa për këtë duhet të bëhet me shkrim.

Shëndeti

Kujtesë e rëndësishme

Bëni sigurimin e detyrueshëm për sëmundjet si për ju vetë edhe për anëtarët e familjes, brenda 3 muajve pas mbërritjes suaj në Zvicër! (shih f. 31)

Probleme shëndetësore: çfarë të bëni?

Në rast problemi shëndetësor, është e rëndësishme të veproni sa më shpejt dhe në mënyrën e duhur.

Në rast nevojë jo të ngutshme, ju mund:

- Të shkoni në një barnatore dhe të kërkonti këshillë nga një farmacist apo farmacist.
- Të merrni takim me mjekun tuaj të përgjithshëm, i cili, në rast nevojë, do t'ju drejtojë te një specialiste apo specialist.
- Kur barnaret dhe kabineti i mjekut të përgjithshëm janë të mbyllur, thërrisni centralin telefonik të mjekëve të rojes në nr. 0848 133 133


Në rast të ngutshëm e me rrezik jete:

- Shkoni në spital, në Shërbimin e urgjencave (Service des Urgences)
- Thërrisni ambulancën në nr. 144

Barnaret

Në Zvicër, barnaret shesin barna mjekësore. Barnaret dhe barnatarët mund të japin edhe këshilla shëndetësore bazë. Oraret e tyre të hapjes përkojnë në përgjithësi me ato të dyqaneve tregtare. Disa barnare janë të hapura të dielën e në mbrëmje deri vonë: ato quhen barnatore roje.





Mjekët e përgjithshëm

Në Zvicër, në përgjithësi ju zgjidhni një mjek apo mjek të përgjithshëm (që quhet edhe mjek.e i familjes). Kjo/ky ndjek dosjen tuaj mjekësore dhe ju drejton te specialistët në rast nevoje. Ju mund të kërkonti edhe një mjek.e që flet gjuhën tuaj. Shoqëria vaudeze e mjekësisë (Société vaudoise de médecine - SVM) propozon një listë mjekësh vaudezë si dhe gjuhët që ata flasin.

 www.svmed.ch

Spitalet lozanezë


Në Lozanë, struktura të ndryshme mjekësore ofrojnë përkujdesje të cilësisë së lartë për banoret dhe banorët (spitale, ambulanca, poliklinika, klinika dhe shërbime urgjence). Ja 3 adresa të rëndësishme:

-  **Centre hospitalier universitaire vaudois (CHUV)**
Rue du Bugnon 46, 1011 Lausanne, 021 314 11 11, www.chuv.ch
-  **Urgences CHUV et Unisanté**
Rue du Bugnon 44, 1011 Lausanne, 021 314 11 11, www.unisante.ch
-  **Hôpital de l'Enfance (HEL)**
Chemin de Montétan 16, 1004 Lausanne, 021 314 84 84, www.chuv.ch/fr/dfme

Mëmësi/Atësi

Së shpejti ju do të bëheni nënë e baba? Përkujdesjet mjekësore që lidhen me shtatzëninë jepen nga gjinekologët dhe mamitë. Shpenzimet merren përsipër nga sigurimi shëndetësor i detyrueshëm, duke filluar nga java e 12të e shtatzënisë.

Me lindjen e fëmijës, nëna ka të drejtë për 14 javë leje lindjeje. Gjatë kësaj periudhe, ajo merr 80 % të rrogës të saj. I ati apo bashkëshortja e nënës së fëmijës ka të drejtë për 14 ditë pagesa dhe 10 ditë leje prindërore. Ai apo ajo duhet ta marrë këtë leje brenda 6 muajve pas lindjes.

Shoqata Panmilar propozon t'ju shoqërojë, në gjuhën tuaj, gjatë shtatzënisë dhe pas lindjes së fëmijës suaj. Ky shoqërim bëhet nga një mami dhe një interpret i bashkësisë suaj. Ky është rasti për të takuar prindër të ardhshëm, për të bërë pyetje dhe për të përgatitur pritjen e fëmijës suaj.  www.panmilar.ch



Shëndeti seksual

Qendra PROFA, në Lozanë, është adresa në të cilën mund të drejtoheni për çdo çështje që ka të bëjë me shëndetin seksual, me çiftin, seksologjinë dhe perinatalitetin (periudha nga fundi i shtatzënisë deri në ditët e para të jetës së fëmijës). Ajo propozon biseda këshilluese dhe vizita mjekësore. Qasja e saj është konfidenciale, përshtatet me gjendjen, bëhet pa diskriminim e pa gjykim.

Centre PROFA Lausanne

Avenue Georgette 1, 1003 Lausanne

www.profa.ch

Shëndeti psikik

Shoqata Appartenances ofron këshillime psikoterapeutike dhe psikiatrike për ata (dhe të afërmit e tyre) që vuajnë nga turbullime që lidhen me: procesin e migrimit, përvojën e jetës në luftë apo torturë, dhe me çdo lloj tjetër forme të dhunës kolektive. Bisedat mund të përkthehen nga një interpret.e i.e bashkësisë përkatëse.

🌐 Consultation Psychothérapeutique pour Migrant-e-s (CPM) Appartenances

Rue des Terreaux 10, 1003 Lausanne

Tel. 021 341 12 50, cpm.lausanne@appartenances.ch

www.appartenances.ch

Njësia Psy&Migrants e CHUV-it lehtëson përfitimin e përkujdesjeve të shëndetit psikik në situata komplekse, nga të imigruarit e rajonit lozanez. Ajo drejton, brenda rrjetit të përkujdesjeve, dhe propozon ekspertiza në fushën e psikiatriisë transkulturore. Ju mund ta kontaktoni me telefon në nr. 079 556 17 89 ose në adresën elektronike psy-migrants@chuv.ch



Dhuna në familje

Dhuna në familje është e ndaluar në Zvicër. Nëse jeni dëshmitar apo viktimë e dhunës në familje, ju mund të kërkonit ndihmë nga specialistët. Ja një listë adresash:

- **Njësia e mjekësisë së dhunës (Unité de médecine des violences) e CHUV-it:** konstatime të lëndimeve fizike www.chuv.ch
- **Qendra Malley-Prairie:** këshillime për të gjitha e të gjithë dhe strehim në rast urgjence për gratë dhe fëmijët e tyre www.malleyprairie.ch
- **Qendra LAVI:** mbështetje psikologjike, juridike, financiare e materiale për viktimat dhe të afërmit e tyre www.profa.ch/lavi
- **Qendra e Parandalimit e Ale-së:** pritje, ndihmë dhe shoqërim i atyre që dëshirojnë t'i japin fund të qenit të dhunshëm www.prevention-ale.ch
- www.violencequefaire.ch: sit internet me informacione të dobishme mbi dhunën

Point D'Eau Lausanne (PEL)

Fondacioni Point D'Eau Lausanne bën oferta të ndryshme për përmirësimin e shëndetit të atyre që janë në gjendje të brishtë. Personeli i tij prej infermierësh, dentistësh, mjekësh, osteopatësh, psikoterapeutësh, masazhistësh e masazhistësh bën konsulta. Fondacioni ofron gjithashtu shërbime në fushën e higjienës (dushe, lavaxteri, floktore).

Point D'Eau Lausanne (PEL)

Avenue de Morges 26, 1004 Lausanne
Tel. 021 626 26 44, info@pointdeau-lausanne.ch
web.pointdeau-lausanne.ch

A e dinit se?

Qyteti i Lozanës ua lehtëson hyrjen në ndërtesa të shumta personave të moshuar apo me aftësi të kufizuara, të cilët kanë vështirësi për të lëvizur. Një listë e këtyre ndërtesave gjendet në sitin e internetit www.lausanne.ch/accessibilite

Transportet



Për të mbrojtur mjedisin dhe luftuar kundër nxehjes klimatike, Qyteti i Lozanës u rekomandon banoreve dhe banorëve të saj të parapëlqejnë lëvizjen aktive e të qëndrueshme, si: ecjen, biçikletën dhe transportet publike. Kjo është pjesë e Planit klima të Qytetit, objektivi i të cilit është të arrijë në 0 % karbon deri më 2030.

CFF (Chemins de Fer Fédéraux)

CFF-ja u propozon oferta për të udhëtuar me tren në Zvicër të gjitha udhëtareve dhe të gjithë udhëtarëve. Ju mund të blini bileta, abonime dhe karta për uljen e çmimit në internet, në sportele apo në aparate, në disa stacione treni. Mund të përdorni edhe aplikacionin «Mobile CFF».

www.cff.ch


Kartat ditore CFF (Flexi-Card) janë në dispozicion të banoreve dhe të banorëve të Lozanës për 49 frz.

www.lausanne.ch/carte-journaliere

Mobilis Vaud

Transportet publike të kantonit të Vaudit janë organizuar me zona tarifore. Ky sistem quhet Mobilis. Lozana u përket zonave 11 e 12. Ju mund të blini bileta për një a më shumë zona. Këto bileta kanë kohëzgjatje vlefshmërie të kufizuar, gjatë së cilës mund të përdorni të gjitha mjetet e transportit publik të zonës së zgjedhur (autobusa, metro apo trena).

www.mobilis-vaud.ch





TL

Me Transportet publike Lozaneze (tl), ju udhëtoni me autobus, tren e metro, në Lozanë dhe në komunat përreth. Ju mund të blini bileta e abonime me SMS, përmes aplikacionit «tl», në sitin e tyre të internetit ose në qendrën e klientelës në Flon. Mos nguroni të konsultoni sitin e tyre të internetit ose të shkoni t'i vizitoni!

📍 **Centre clientèle TL Flon**
Place de l'Europe 5B, 1003 Lausanne
Tel. 021 621 01 11, www.tl.ch

Në kuadrin e Planit klima, Qyteti i Lozanës ofron subvencione për abonimet tl Grand Lausanne (zones 11+12) për pensionistët dhe të rinjtë në formim.
www.lausanne.ch/rabais-tl

Biçikleta

Qyteti i Lozanës lehtëson lëvizjen me biçikletë, duke krijuar pista të posaçme për to dhe duke favorizuar blerjen e biçikletave elektrike. Ajo kthen një pjesë të çmimit të blerjes së biçikletave elektrike: 15 % (e shumta 400 frz.), 30 % (e shumta 800 frz.) për ata që janë nën moshën 25 vjeç dhe ata që kanë të drejtë për ndihmën plotësuese të sigurimit shëndetësor të detyrueshëm («subside»). Për të përfituar nga ky kthim, ju mund të bëni kërkesë në www.equiwatt.ch.

Ecja në këmbë

Ecja në këmbë është mjeti më i thjeshtë dhe ekologjik për të përshkuar largësi të vogla. Edhe kjo veprimtari fizike rekomandohet për të qëndruar në gjendje të mirë shëndetësore. Qyteti i Lozanës bën gjithçka për t'i bërë ecjet në këmbë më të sigurta e më të këndshme: vendkalime për këmbësorët, nën-kalime, itinerarë të blertë, zgjerim i zonave këmbësore dhe me trafik të kufizuar.

www.lausanne.ch/pietons

Makina apo mjete i motorizuar


Keni leje drejtimi të huaj? Pas mbërritjes në Lozanë, ndërrojeni me leje drejtimi zvicerane. Keni një apo disa automjete? Kërkoni shpejt targa zvicerane. Këto dy përçapje duhet të bëhen pranë Shërbimit të automjeteve dhe të lundrimit (Service des automobiles et de la navigation - SAN), brenda një afati prej 12 muajsh pas mbërritjes suaj në Lozanë.

Service des automobiles et de la navigation (SAN)

Avenue du Grey 110, 1014 Lausanne

Tel. 021 316 82 10, www.vd.ch/san

Kujdes: duke filluar nga viti 2030, automjetet termike (motori i të cilave funksionon me benzinë ose me naftë) nuk do të lejohen të qarkullojnë më në Lozanë.



Vendet e parkimit

Në Lozanë, ju mund të merrni me qira vende parkimi private brenda ose në afërsi të vendit tuaj të banimit. Ju mund ta parkoni mjetin tuaj edhe në vende parkimi publike. Ka edhe dy mundësi të tjera parkimi që duhen ditur:

- **Parkings-Relais (P+R):** fala është për një ofertë të kombinuar, d.m.th. një vend parkimi për mjetin tuaj dhe një kartë të transporteve publike për zonën 11+12. Kështu ju mund ta parkoni makinën në njërin prej 6 vendeve të parkimit stafetë («parkings-relais») që gjenden në periferi të Lozanës dhe pastaj të shkoni në qendër të qytetit me metro ose me autobus. Kjo ofertë është e vlefshme për një ditë, një muaj a më tepër.
- **Macarons:** banoret dhe banorët e Lozanës mund të blejnë një pullë parkimi (macaron) për ta lënë makinën më gjatë në zonat blu. Ato mund t'i kërkonin në sitin e internetit ose në sportelin e Zyrës së qarkullimit dhe parkimit (Office de la circulation et du stationnement) të policisë lozaneze.

📍 Office de la circulation et du stationnement

Rue St-Martin 31, 1002 Lausanne

Tel. 021 315 38 00, police@lausanne.ch

www.lausanne.ch/stationnement

Nga e marta deri të premten ora 7.30-17.00

A e dinit se?

Në Zvicër, fëmijët udhëtojnë falas deri në moshën 6 vjeç, pastaj, nga 6 deri në 16 vjeç, me gjysmë tarifë. Me kartën «Junior» (30 frz. në vit), fëmijët deri në moshën 16 vjeç të shoqëruar nga prindërit mund të udhëtojnë falas në gjithë rrjetin e transporteve publike zvicerane. Mbani shënim se biletat e transportit janë të detyrueshme edhe për qentë ... e biçikletat!

Financat, tatimet dhe telekomunikacioni

Çelja e një llogarie bankare

Për derdhjen e rrogës, pagimin e faturave apo dërgimin e parave jashtë shtetit, është e dobishme të çelni sa më parë një llogari bankare në Zvicër. Për ta bërë këtë, ju mund:

- Të shkoni në sportelet e bankave
- Të konsultoni sitet e tyre të internetit

Për çeljen e llogarisë, disa banka ju kërkojnë një dokument identiteti dhe një vërtetim të vendbanimit dhe/ose të rrogës.

Tatimet

Qysh nga mosha 18 vjeçare, cilido që jeton në Zvicër - që ka apo jo punë dhe rrogë - duhet të paguajë tatime. Për këtë, duhet të plotësoni deklaratën vjetore të tatimeve. Këtë dokument jua dërgon autoriteti fiskal në fillim të vitit. Ai mund të plotësohet edhe në linjë, me anën e aplikacionit VaudTax.

www.vd.ch/vaudtax

Nëse jeni me rrogë, mendoni të lajmëroheni pranë autoritetit fiskal për pagimin e kapareve mujore. Këtë mund ta bëni në linjë në sitin www.vd.ch/acomptes. Punonjëseve dhe punonjësve të huaj, që nuk janë të pajisur me leje qëndrimi vendosjeje C (permis C), tatimi u zbritet nga rroga. Ky tatim u merret drejtpërdrejt nga rroga.

Administration cantonale des impôts (ACI)

Route de Berne 46, 1014 Lausanne


Tel. 021 316 00 00, www.vd.ch/impots

Nga e hëna deri të premten ora 8.00-17.00

Keni nevojë për ndihmë për plotësimin e deklaratës së tatimeve?

Shkoni në shërbimet e gatshme të AVIVO-s.

www.avivo-vaud.ch/permanences



Tatimi për qentë

Në Lozanë, ju paguani tatim edhe për qentë. Ju duhet ta deklaroni qenin tuaj pranë Zyrës lozaneze të tatimeve. Këtë përçapje mund ta bëni:

- Me telefon në nr. 021 315 43 21
- Me internet në www.lausanne.ch/impots

Buxheti dhe borxhet

Keni pyetje lidhur me borxhet? Keni borxhe? Në «Parlons cash!», ka specialistë që ju informojnë, këshillojnë e orientojnë për në institucione apo shoqata në varësi të gjendjes dhe nevojave tuaja.

Parlons cash!

Tel. 0840 43 21 00, www.vd.ch/parlons-cash

Nga e hëna deri të enjten, ora 8.30 deri në orën 13.00

Shërbimi social i Lozanës (Service social de Lausanne - SSL)


Shërbimi social i Lozanës u vjen në ndihmë personave me banim në Lozanë, të cilët janë në nevojë. Ndihma sociale në kantonin e Vaudit përfshin një ndihmë financiare dhe masa për integrimin social e profesional. Në sitin e internetit të këtij shërbimi, do të gjeni ofertat e ndryshme të tij, të klasifikuara sipas tematikës dhe ofruesve të tyre.

📍 Service social Lausanne (SSL)

Place Chauderon 4, 1002 Lausanne

Tel. 021 315 75 11, ssl@lausanne.ch, www.lausanne.ch/ssl

Nga e hëna deri të premten ora 8.30-11.45, 13.00-16.30
(mbyllur të enjten paradite)



Telefoni, televizioni dhe interneti

Në Zvicër, shumë ndërmarrje propozojnë abonime ose oferta («forfaits») për telefonin, televizionin dhe internetin. Ju mund të kërkonit një ofertë të kombinuar, që përfshin disa shërbime. Edhe Shërbimet industriale të Lozanës (Services industriels de Lausanne - SiL) kanë një ofertë për telefonin, televizionin dhe internetin. Kjo ofertë quhet Citycable (shih f. 16). Për më shumë informacion, shkoni në dyqan ose hyni në internet.



Taksa SERAFE

Çdo person që regjistrohet në kontrollin e banorëve merr - një herë në vit - një faturë për radion e televizionin. Kjo taksë quhet «redevance Serafe». Ajo është e detyrueshme për çdo familje.

www.serafe.ch

A e dinit se?

Për të imigruarit, përfitimi nga ndihma sociale nganjëherë mund të ndikojë në marrjen apo ripërtëritjen e lejes së qëndrimit. Informohuni pranë shërbimit social të Lozanës (shih f. 43) ose në Fraternité - CSP Vaud (shih f. 13).



Argëtimet

Arti dhe kultura

Lozana është qytet kulture. Atje ju do të gjeni oferta të shumta në fusha të ndryshme, si: muzika, artet skenike, artet vizuale dhe kinemaja. Dhe në vende të ndryshme si bibliotekat, sallat e shfaqjeve, muzetë dhe galeritë. Lozana pret edhe festivale dhe festa që zhvillohen mbrëmjeve dhe që tërheqin një publik që vjen nga gjithë Zvicra dhe nga Evropa.

www.lausanne.ch/culture

Në broshurën e Zyrës lozeneze për të imigruarit (Bureau lausannois pour les immigrés - BLI) «Të mësosh në Lozanë» (Apprendre à Lausanne), mund të gjeni një listë të bibliotekave që propozojnë libra për të gjitha moshat, në frëngjisht e në gjuhë të huaja.

www.lausanne.ch/apal

Sporti dhe veprimtaria fizike

Si kryeqytet Olimpik, Lozana përkrah sportin për të gjitha e të gjithë dhe nxit jetën e shëndetshme dhe aktive. Qyteti ka afër 300 klube sportive dhe pret më shumë se 50 veprimtari sportive çdo vit. Lozana ofron gjithashtu edhe infrastruktura të shumta për popullsinë. Për shembull: qendra sportive, terrene sporti, «fitness»-e jashtë, pishina dhe pista patinazhi.

www.lausanne.ch/sport

Në kalendarin e sitit të internetit të Qytetit të Lozanës, do të gjeni të gjitha ngjarjet kulturore e sportive të Lozanës. Ju mund t'i kërkonti ato sipas temës, vendit apo datës.

www.lausanne.ch/agenda



Turizmi

Lausanne Tourisme jep informacione mbi veprimtaritë, ngjarjet, restorantet dhe shëtitjet që ju mundësojnë zbulimin dhe vlerësimin e qytetit. Në sportelin e Zyrës së turizmit lozanez mund të merrni këshilla dhe dokumentacion të dobishëm (broshura, plan të qytetit, etj.)

www.lausanne-tourisme.ch



Veprimtaritë shoqërore e kulturore

Lozana numëron 5 shtëpi lagjesh, 10 qendra shoqërore e kulturore dhe 2 terrene aventure. Në këto vende organizohen veprimtari të larmishme, për të gjitha moshat. Qëllimi është të lehtësohen takimet dhe të nxiten lidhjet shoqërore midis lozanezeve dhe lozanezëve. Ato administrohen nga Fondacioni lozanez për veprimtari shoqërore e kulturore (Fondation pour l'animation socioculturelle lausannoise - FASL), në bashkëpunim me shoqatat e lagjes.

www.fasl.ch

A e dinit se?

Hyrja në shumicën e muzeve të Lozanës është falas të shtunën e parë të muajit!



Jeta qytetare

Sistemi politik zviceran

Zvicra është shtet federal i organizuar në tri nivele politike: Konfederata, Kantonet dhe Bashkitë. Ajo ka 26 kantone, 2136 bashki (më 1 janar 2023) dhe një popullsi prej 8,7 milionë banorë.e.

Zvicra është demokraci gjysmë e drejtpërdrejtë. Ajo qeveriset nga Kuvendi federal (pushteti ligjvënës), gjykatat federale (pushteti juridik) dhe Këshilli federal (pushteti ekzekutiv). Presidentja apo Presidenti zgjidhen ndër shtatë anëtarët e Këshillit federal dhe ndërrohen çdo vit.

Të drejtat politike

Në Zvicër qytetarët dhe qytetarët kanë të drejta politike qysh nga mosha 18 vjeç. Kjo u mundëson atyre:

- Të votojnë
- Të zgjedhin
- Të zgjidhen
- Të ndërmarrin dhe të nënshkruajnë nisma popullore ose referendume


Popullsia zvicerane thërritet shpesh në votime për vendime bashkiake, kantonale apo federale dhe për zgjedhjen e përfaqësuesve dhe përfaqësuesve politikë.

Ju do të gjeni informacione mbi të drejtat politike dhe votimet në sitin

www.lausanne.ch/votations

Partitë politike

Në Zvicër ka shumë parti politike. Partitë politike janë shoqata njerëzish që ndajnë të njëjtat ide. Ato përfaqësojnë interesat dhe mendimet e popullsisë zvicerane dhe u transmetojnë autoriteteve kërkesat e popullit. Në Lozanë, të zgjedhurit në këshillin bashkiak apo në organin ekzekutiv të bashkisë («Municipalité») janë të gjithë anëtarë të një partie politike.



Takime qytetare të BLI-së

Zyra lozaneze për të imigruarit (Bureau lausannois pour les immigrés - BLI) organizon takime qytetare. Këto takime synojnë të nxisin pjesëmarrjen politike e shoqërore të personave të dalë nga gjiri i të imigruarve dhe tërë popullsisë. Mund të bëhet falë për seanca informuese, momente shkëmbimi apo vizita me udhërrëfyes.

www.lausanne.ch/bli-rdvcitoyens

Puna vullnetare

Puna vullnetare është shumë e përhapur në Zvicër. Të bësh punë vullnetare do të thotë: të japësh nga koha jote për një kauzë, një organizatë, një veprimtari. Puna vullnetare nuk paguhet, por ajo pasuron shoqërinë, forcon marrëdhëniet shoqërore dhe rrit mirëqenien e çdo qytetareje dhe qytetari. Dëshironi të angazhoheni? Ka shoqata që ju ndihmojnë:

www.benevolat-vaud.ch

www.volontaireslausannois.ch



Marrja e shtetësisë (Naturalisation)

Me disa kushte (pikërisht 10 vjet qëndrim në Zvicër, 2 vjet në kantonin e Vaudit, lejen e qëndrimit C (permis C)), ju mund të kërkonti shtetësinë zvicerane. Flitet për kërkesë shtetësie (demande de naturalisation). Informohuni për këtë përçapje pranë zyrës së shtetësisë! Në sitin e saj të internetit, ju do të gjeni edhe oferta për kurse dhe broshura informuese.

📍 Naturalisations - Bureau lausannois pour les immigrés (BLI)

Place de la Riponne 10, 1002 Lausanne


Tel. 021 315 22 31, naturalisations@lausanne.ch

www.lausanne.ch/naturalisation

Të martën e të premten ora 10.00-12.00

A e dinit se?

Në Lozanë, personat me shtetësi të huaj, që kanë leje qëndrimi B apo C (permis B ou C) qysh prej 10 vjetësh dhe që banojnë në kantonin e Vaudit qysh prej 3 vjetësh, kanë të drejta politike. Ata mund të votojnë në nivel bashkiak, të zgjedhin dhe të zgjidhen në këshillin bashkiak apo në organin ekzekutiv të bashkisë («Municipalité») dhe të nënshkruajnë nisma dhe referendume bashkiake.



PLAN ORIENTIMI

- 1. Agence d'assurances sociales (AAS)** (f. 31)
Place Chauderon 7
- 2. Bibliothèque Chauderon**
Place Chauderon 11
- 3. Bibliothèque Jeunesse**
Avenue d'Echallens 2A
- 4. Bureau cantonal pour l'intégration des étrangers et la prévention du racisme (BCI)** (f. 12)
dont «Mariage forcé» (f. 28)
Avenue de Sévelin 46
- 5. Bureau lausannois pour les familles (BLF)** (f. 29)
Place Chauderon 9, étage T
- 6. Bureau lausannois pour les immigrés (BLI)** (f. 11)
dont «Vivre, se former, travailler» (f. 10)
«Info Racisme» (f. 12)
et «Naturalisations» (f. 49)
Place de la Riponne 10
- 7. Centre clientèle tl Flon** (f. 39)
Place de l'Europe 5B
- 8. Centre d'orientation professionnelle** (f. 24)
et **Portail Migration** (f. 26)
Rue de la Borde 3D
- 9. Centre hospitalier universitaire vaudois (CHUV)** (f. 35)
Rue du Bugnon 46
- 10. Centre social protestant Vaud (CSP Vaud) - La Fraternité** (f. 13)
Place Arlaud 2
- 11. Domaine accueil vacances** (f. 30)
Place Chauderon 7a, étage T
- 12. ECA - Agence de Lausanne** (f. 33)
Avenue du Grey 111
- 13. Gare de Lausanne**
- 14. Hôpital de l'Enfance (HEL)** (f. 35)
Chemin de Montétan 16
- 15. Hôtel de police**
Rue St-Martin 33
- 16. Info cité** (f. 9)
Place de la Palud 2
- 17. Inspection du travail Lausanne** (f. 21)
Place de la Riponne 10
- 18. Office de la circulation et du stationnement** (f. 41)
Rue St-Martin 31
- 19. Office régional de placement (ORP)** (f. 22)
Place Chauderon 9
- 20. Service du contrôle des habitants (CH)** (f. 16)
Rue du Port-Franc 18
- 21. Service d'architecture et du logement** (f. 18)
Place Chauderon 9
- 22. Service des automobiles et de la navigation (SAN)** (f. 40)
Avenue du Grey 110
- 23. Service des écoles et du parascolaire** (f. 25)
Place Chauderon 9
- 24. Service des gérances** (f. 18)
Place Chauderon 9
- 25. Services industriels de Lausanne (SiL)** (f. 16)
Place Chauderon 23
Place de l'Europe 2
- 26. Service social de Lausanne (SSL)** (f. 43)
Place Chauderon 4
- 27. Urgences CHUV et Unisanté** (f. 35)
Rue du Bugnon 44


JASHTË PLANIT

- 12 22 14

NË TË NJËTËN
ADRESË

- 5 19 21
23 24





B.L.I.

**BUREAU LAUSANNOIS
POUR LES IMMIGRÉS – B.L.I.**

Place de la Riponne 10

Tel. 021 315 72 45

www.lausanne.ch/bli

Gjendet në:

Albanais / Shqip

Allemand / Deutsch

Anglais / English

Arabe / العربية

Bosnien-Croate-Serbe /
Bosanski-Hrvatski-Srpski

Espagnol / Español

Farsi / فارسی


Français

Italien / Italiano

Portugais / Português

Russe / Русский язык

Ukrainien / Руди



www.lausanne.ch/bli-vivre-a-lausanne

Bureau lausannois pour les immigrants (BLI)

Place de la Riponne 10
case postale 5032
1002 Lausanne

T +41 21 315 72 45
www.lausanne.ch/bli
bli@lausanne.ch

